

Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të Programit për kulturë për vitin 2020 dhe në suazat e projektit për realizimin e Programit për zhvillimin e industrive kreative, shpall

THIRRJE PUBLIKE

për përgatitjen e projektit ideor me realizimin
e Festivalit “Shkupi kreative” në muajin qershor të vitit 2020

Festivali për zhvillimin e industrive kreative të Qytetit të Shkupit për vitin 2020.

Programi për zhvillimin e industrive kreative për vitin 2020 duhet të sigurojë promovimin e vlerave, prodhimeve dhe shërbimeve nga fusha e industrive kreative siç janë: dizajni (industrial, grafik, dizajni i modës), dizajn mobilie dhe arkitekturë, arte audio-vizuale, medime të reja, teknologji IT, arte performuese etj.

E drejta për pjesëmarrje

Në Thirrjen publike mund të marrin pjesë persona juridikë të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë nga fusha e kulturës dhe legjislacionit pozitiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kushtet e financimit

Për marrjen e mjeteve financiare për realizimin e Programit të zhvillimit të industrive kreative për vitin 2020, personat juridikë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Personat juridikë duhet të jenë regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Personi juridik aplikon me program me koncept inventiv (fokusi në Shkupi kreative 2020), i njëjti mund të jetë në partneritet me institucione dhe organizata kombëtare, publike, private ose të pavarura nga fusha e kulturës, shkencës, teknologjisë dhe/ose fusha të tjera të ekonomisë.

- Personi juridik duhet të sigurojë vendin përkatës për realizimin e projektit.

- Personi juridik duhet të ketë një listë referuese ose CV nga më së paku tri (3) projekte të realizuara nga fusha e kulturës ose industrive krijuese.

- Personi juridik duhet të ketë përvojë në mentorimin ose realizimin e punëtorive, trajnimeve, ligjëratave nga fusha e kulturës ose industrive krijuese.

Kritere për pjesëmarrje

Të drejtën për realizimin e Programit të zhvillimit të industrive kreative për vitin 2020 do ta fitojë personi juridik që do të ofrojë program/prototip/projekt dizajn që plotëson disa nga kriteret e mëposhtme:

- Origjinaliteti dhe inovacioni i konceptit të programit/projektit, me qëllim kapërcimin e ndarjeve klasike nga fusha e artit dhe dizajnit.

- Qasje moderne në lidhjen e teknologjive të reja dhe mediave digjitale në krijimtarinë artistike dhe format e tjera të shprehjes krijuese.
- Promovim dhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e industrive krijuese.
- Plan veprimi për realizimin e aktiviteteve në suazat e programit/projektit.
- Aktivitete multi – disiplinore dhe multi – kulturore që janë të paraparë në suaza të programit – projektit.
- Involvimi i industrive kreative në proceset formale dhe jo – formale arsimore në Shkup, me qëllim të zhvillimit të një rinie kreative.
- Nxitja e aftësive sipërmarrëse dhe afariste të rinjtë, artistët, dizajnerët dhe individët / grupet në suaza të industrive kreative.
- Aktivitete me potencial të shitjes (duke i përfshirë edhe popap – shitoret).
- Qëndrueshmëria e programit / projektit që do të bazohet mbi konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Aktivitete me karakter ndërkombëtarë, prania e ekspertëve nga fusha e industrive kreative (përmes partneriteteve dhe bashkë produksioneve).
- Stimulimi, realizimi dhe prezantimi i krijimtarisë së potencialeve kreative të fëmijët dhe të rinjtë, për realizimin e projekteve kreative.
- Oferta më të volitshme financiare, e cila realisht mund të realizohet.

Tabela me kriteret për zgjedhjen e projektit më të mirë:

Kriteret:	Pikat maksimale
1. Struktura organizative dhe përvoja	40
1.1 Vallë aplikuesi posedon resurset e nevojshme teknike për realizimin e propozim projektit	10
1.2 Profesionistët që marri n pjesë në realizmin e projektit	10
1.3 Transparenca e aplikuesit (organizatës, shoqatës, agjencisë) online	10
1.4 Vallë aplikanti posedon përvojë relevante në realizimin e projekteve të ngjashme	10
2. Plan i financiarë	20
2.1 Vallë personi juridik siguron përqindjen e pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit	10
2.2 Vallë plani i propozuar financiarë është real	10

3. Cilësia e projektit	40
3.1 Në çmasë qëllimi i përgjithshëm do të kontribuoj për realizimin e prioriteteve të përcaktuara, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë përkatëse	10
3.2 Zgjidhje të ofruara cilësore dhe inovative me propozim projektin	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave tjera	10
3.4 Aktivitete me karakter ndërkombëtarë, prezenca e ekspertëve nga fusha e industrive kreative (përmes partneritetit dhe bashkë prodhimit).	10

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar, nevojitet që të marrin fletëparaqitjen nga ueb faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit, të njëjtën në tërësi ta plotësojnë, nënshkruajnë dhe verifikojnë me vule (për personat juridik) në zarf të mbyllur ta dorëzojnë deri te arkivi i Qytetit të Shkupit.

Përkaj fletëparaqitjes, kandidatët detyrimisht duhet të dorëzojnë edhe:

Dokumentet e nevojshme:

- Fletëparaqitja për pjesëmarrjes
- Plani financiarë (konstrukcioni i detajuar financiarë)
- Projekti ideor me përshkrim të aktiviteteve
- Plani i detajuar për realizimin e aktiviteteve
- Vërteti i nga DAP për tatimet e paguara dhe të taksave tjera publike
- Titulli, përshkrimi i detajuar, skica, koncepti i propozim – projektit për prototip, projekt dizajni, programi me propozim konstrukcionin financiar për realizimin e tij për personat juridik. Të dhënat themelore nga regjistrimi i personit juridik.
- Llogaria rrjedhëse jo më e vjetër se 6 muaj nga Regjistri Qendrorë i RMV-së (kopje në trajtë të printuar).
- Biografi / CV / Listë referente (evidenca) e projekteve të realizuara më parë në trajtë të printuar.
- Portofol profesional në USB.
- Fletëparaqitje e plotësuar në mënyrë të saktë.
- Biografi profesionale / CV e profesionistëve.
- Bashkëpunëtorët që do të angazhohen në realizimin e projektit (Dokumentet të dorëzohen në trajtë të printuar dhe në trajtë digjitale USB).

Thirrja publike zgjat (30 ditë) nga dita e shpalljes, përkatësisht nga 16.03.2020 deri më 14.04.2020.

Fletëparaqitjet mund të merren në Sektorin për veprimtari publike – Seksioni për kulturë, Baraka 2 dhe në ueb faqen e Qytetit të Shkupit dhe të njëjtit duhet të dorëzohen deri te Arkivi i Qytetit të Shkupit, përmes postës ose personalisht në adresën Bul. “Ilinden” nr. 82 deri në ora 18:00.

Komisioni i emëruar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit, miraton aktvendim për fletëparaqitjet më të volitshme dhe do ti njoftoj parashtruesit e fletëparaqitjeve për përzgjedhjen e kryer.

Fletëparaqitjet me të dhëna të pa plota, si dhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e lartpërmendur, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të sigurohen në telefonin 02/3297-324 ose në e - mailin kultura@skopje.gov.mk

Kryetari i Qytetit të Shkupit

Petre Shilegov
